



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 783 Prot.

Tiranë, më datë 26.05.2023

VENDIM
Nr. 296, datë 26.05.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 26.05.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Potencialit Arkeologjik në kuadër të projektit “Rindërtim godinë banimi 2 kat me çati”, Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike "A", Durrës, me Nr. Pasurie 2/227, Zona Kadastrale 8514, me vendndodhje Rruga “Nazmije Vigani”, Lagjia Nr. 4, Bashkia Durrës, me aplikues Jani Tati dhe zhvillues **Gëzim Plakalli**;
2. Subjekti zhvillues të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
3. Gjatë procesit të zbatimit siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgimie kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” nga DRTK Tiranë;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
5. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

KRYETAR
Elva MARGARITI

